

Emertimi dhe Forma ligjore:

NIPT –i:

Adresa e Selise:

Data e krijimit:

Nr. I Regjistrimit Tregtar

Veprimtaria Kryesore:

“ A&A PHARMA ”sh.p.k

L22103004V

Tirane

03/09/2012

Import dhe tregetim me shumice te medikamenteve mjekesore, barnave mjekesore.

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr 2 dhe Ligjit Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”)

VITI 2020

Pasqyrat Financiare jane individuale

Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek

Pasqyrat Financiare nuk jane te rumbullakosura

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2020-31.12.2020

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare 25.03.2021

SHENIMET SHPJEGUESE

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "A&A PHARMA" sh.p.k është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 03/09/2012 në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Mbi Shoqëritë Tregtare". Shoqëria është regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tirane me NIPT L22103004V. Selia e shoqërisë është në Autostrada Tr-Dr, Km.4, Kashar (ne ambientet e shoqërisë AQUILA GROUP), Tirane. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 3,000,000 LEK.

Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas Ligjit Nr.9901 datë 14/04/2008 "*Për Tregtarët dhe shoqëritë tregëtare*" statutit të saj dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 Maj 2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*".

Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 "*Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre*", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 Janar 2015.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe

supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2020	2019
Euro/LEK	123.7	121.77
USD/ LEK	100.84	111.36

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin

efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përfaqësohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e

çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të Tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Bilanci kontabel, aktivet

4. Aktive monetare

Gjendja e aktiveve monetare ne date 31.12.2020 eshte ne shumen 46,872,512 leke si me poshte:

Nr	Likujditete	Viti 2020	Viti 2019
1	Banke	24,905,794	7,033,990
2	Arka	21,966,718	7,960,909
	Totali	<u>46,872,512</u>	<u>14,994,899</u>

Gjendja e likujditeteve, detyrimet dhe kerkesat ndaj te treteve ne monedhe te huaj gjendje ne 31.12.2020 jane konvertuar me kursin e dates 31.12.2020 te Bankes se Shqiperise dhe diferencat jane marre ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

5. Te drejta te arketushme

Paraqitet gjendja e kerkesave te pa arketuara me 31.12.2020 ne shumen 16,589,550 leke.

Nr	Te drejta te arketueshme	Viti 2020	Viti 2019
1	Nga aktiviteti i shfytëzimit	10,430,353	2,258,865
2	Te tjera	6,159,197	289,951
3	Parapagime te dhena	0	0
	Totali	<u>16,589,550</u>	<u>2,548,816</u>

5.1 Nga aktiviteti i shfrutezimit

Paraqitet shuma prej 10,430,353 leke, e cila paraqet kerkesen ndaj klienteve , te paraketuar deri ne daten 31.12.2020.

5.2 Te tjera

Paraqitet shuma prej 6,159,197 leke me 31.12.2020 e cila paraqet kerkesen per :

1	Parapagim Dogana	753,624
2	Shteti-TVSH e pagueshme	5,405,573

6 Inventaret

Gjendja e inventarit, Lende te para, me 31.12.2020 eshte 29,472,365 leke, si me poshte :

Nr	Inventaret	Viti 2020	Viti 2019
1	Lendet e para	27,986,615	2,845,675
2	Provizionim i zhvleresimit te lendeve te para	-3,001,185	
3	Mallra	4,684,616	4,306,084
4	Provizionim i zhvleresimit mallra	-197,680	
	Totali	<u>29,472,365</u>	<u>7,151,759</u>

- ❖ Vleresimi i mallrave ne momentin e blerjes eshte bere me koston e hyrjes veprimet e daljes e te gjendjeve te inventarit jane bere me kosto mesatare e cila nuk ka ndryshuar ne vite.
- ❖ Te gjitha transaksionet e kryera si blerje, shitje, kalim ne llogarite e shpenzimeve vjetore i perkasin ushtrimit kontabel te vitit 2020.

7 Aktive afat gjata materiale

Gjendja e aktiveve afat gjata eshte paraqitur me vleren kontabel te mbetur, vlere fillestare minus amortizimin e mbartur, e cila me 31.12.2020 eshte 4,344,557 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Toka dhe ndërtesa	0	0
2	Mjete transporti	76,459	95,573
3	Makineri e pajisje	3,642,312	56,000
4	Pajisje zyre dhe informatike	625,786	84,047
	Totali	<u>4,344,557</u>	<u>235,620</u>

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019.

Bilanci kontabel, pasivet.**8 Detyrimet Afatshkurtra**

Ne kete post paraqitet gjendja e detyrimeve afatshkurtra me 31.12.2020 ne shumen 85,248,010 leke.

Nr	Detyrimet afatshkurtra	Viti 2020	Viti 2019
1	Arkëtime në avancë për porosi	0	0
2	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	83,438,935	20,342,349
3	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	201,841	168,249
4	Të pagueshme për detyrimet tatimore	1,607,234	27,696
5	Te pagueshme te tjera	0	0
	Totali i detyrimeve	<u>85,248,010</u>	<u>20,538,294</u>

8.2 Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Ne kete post jane te perfshira detyrimet e shoqerise ndaj furnitoreve ne 31.12.2020 ne shumen 83,438,935 leke

8.3 Të pagueshme per sigurime shoqerore

Ne kete post jane te perfshira detyrimet e shoqerise per sigurime shoqerore e shendetesore ne shumen 201,841 me 31.12.2020.

8.4 Të pagueshme për detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore paraqiten ne shumen 1,607,234 leke dhe jane te detajuara si me poshte.

Nr	Detyrimet tatimore	Viti 2020	Viti 2019
1	Tatimi mbi te ardhurat personale	35,397	27,696
2	Tatim fitimi sipas bilancit	1,571,837	0
	Totali i detyrimeve	<u>1,607,234</u>	<u>27,696</u>

9 Kapitali

Kapitalet e veta jane ne shumen 12,030,974 leke. Kapitali i vet eshte rritur me fitimin e vitit ushtrimor per 7,634,264 leke. Te detajuara jane ne tabelen e meposhtme:

Nr	Emertimi	Kapitali i regjistruar	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	Divident	Fitimi i vitit	Totali
1	Gjendja me 31.12.2019	3,000,000	357970	0	0	1,034,740	4,392,710
2	Shtesat per 2020			0	0	7,638,264	7,638,264
3	Paksimet per 2020	-	-	0	0	0	
4	Gjendja me 31.12.2020	<u>3,000,000</u>	<u>357,970</u>	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>8,673,004</u>	<u>12,030,974</u>

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve**10 Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit**

Gjate vitit 2020 shoqeria ka realizuar te ardhura nga aktiviteti ne shumen 179,670,793 leke, si me poshte:

Nr	Pershkrimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	179,670,793	29,606,977
	Shuma	<u>179,670,793</u>	<u>29,606,977</u>

Sqarim për moskuadrin e të ardhurave:

Sqarojmë se moskuadrin e të ardhurave të paraqitur ne FDP-te mujore dhe të ardhurave të raportuara në bilanc vjen si rezultat i minusimit te parapagimeve te klienteve prej vitit 2018 .

Nr	Pershkrimi	Viti 2020
1	Të ardhura të raportuara me FDP	179,291,093
2	Të ardhura nga aktiviteti	179,670,793
3	Diferenca	<u>379,700</u>

11 Lendet e para dhe materialet e konsumueshme

Ne kete ze jane te perfshira materialet e konsumuara te vitit 2020 ne shumen 133,852,358 si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Blerje materiale	159,371,828	18,888,645
2	Ndryshimi i gjendjes	-25,519,470	927,712
	Shuma I	<u>133,852,358</u>	<u>19,816,357</u>
Nr	Te tjera shpenzime		
1	Sherbime nga te trete	0	0
	Shuma II	<u>0</u>	<u>0</u>
	Shuma e materialeve te konsumuara	<u>133,852,358</u>	<u>19,816,357</u>

12 Kosto e punes

Totali i koston se punes per vitin 2020 eshte 9,983,456 leke.

Nr	Kosto e Punes	Viti 2020	Viti 2019
1	Shpenzime per paga	8,554,804	6,246,717
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	1,428,652	990,718
	Shuma	<u>9,983,456</u>	<u>7,237,435</u>

13 Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Ne kete ze jane perfshire amortizimet e aktiveve afat gjata materiale per vitin 2020 ne shumen 196,238 leke.

Nr	Pershkrimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Amortizimi i pajisje informatike	104,998	5,381
2	Amortizimi i mjeteve te transportit	19,115	23,893
3	Amortizimi makineri dhe pajisje	72,125	14,000
	Shuma	<u>196,238</u>	<u>43,274</u>

14 Shpenzimet e tjera shfrytesimi

Ne kete ze jane perfshire shpenzime te tjera ne shumen 22,902,925 leke, per vitin 2020, te cilat jane detajuar si me poshte :

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Qira	1,125,000	600,000
2	Shpenzime te tjera	1,022,046	0
3	Mirembajtje dhe riparime	136,618	10,834
4	Sigurime	0	0
5	Te tjera	16,770,243	293,452
6	Shpenzime kancelarie	59,775	
7	Personel nga jashte ndermarrjes	0	30,000
8	Shpz.postare e telekom.	156,640	163,028
9	Transferime, udhetim, dieta	2,401,000	0
10	Tatime, taksa mbi porosite	3,874	0
11	TAN	0	0
12	Taksa dhe tarifa vendore	112,100	101,000
13	Tatime te tjera	46,818	7,164
14	Takse skanimi	9,089	3,309
15	Subvencione te dhena	27,400	244,482
16	Gjoha dhe demshperblime	10,000	0
17	Shpenzime te tjera	1,022,322	
	Shuma	<u>22,902,925</u>	<u>1,453,269</u>

Kuadrimi i blerjeve me shpenzimet e paraqitura në bilanc

Në tabelën e mëposhtme paraqitet kuadrimi i blerjeve të pasqyruara në FDP mujore me shpenzimet e përfshira në pasqyrat financiare për vitin 2020

Nr	Sipas FDP	Shuma ne lekë
1	Blerje të përjashtuara	1,195,988
2	Blerje investime brenda vendit pa TVSH	375,297
3	Importe mallra të përjashtuara	0
4	Importe mallra me shkallë 20%	7,392,676
5	Importe të investimit me shkallë 20%	3,816,720
6	Blerje nga furnitorë vendas	169,929,949
7	Blerje të investimit brenda vendit me tvsh 20 %	274,356
	Totali i blerjeve	182,984,986
	- Zbriten Investimet	-4,305,174
	- Diferenca prej cmimeve te references	-640,527
	Totali i blerjeve	178,039,285
Nr	Sipas bilancit	
1	Blerje materiale	133,852,358
2	Shpenzime te personelit	9,983,456
3	Zhvlerësimi i inventareve	3,198,865
4	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	196,238
5	Shpenzime te tjera shfrytezimi	22,902,925
6	Shpenzime financiare	63,419
	Shuma	170,197,260
	Diferenca	-7,842,026
1	Ndryshim gjendje	-25,519,471
2	Zhvlerësimi i inventareve	3,198,865
3	Shpenzime te personelit	9,983,456
4	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	196,238
5	Shpenzime financiare	63,419
6	Blerje /shpenzime te tjera	117,117
7	Te tjera	376,180
8	Mirembajtje dhe riparime	136,618
9	Shpenzime kancelarie	350
10	tatime, taksa mbi porositë	3,874
11	Taksa dhe tarifa vendore	112,100
12	Tatime te tjera	46,818
13	TAKSE SKANIMI	9,089
14	Gjoha dhe demshperblime	10,000
15	Dieta	2,401,000
16	Shp. te panjohura	1,022,322
		-7,842,025
	Diference FDP-Bilanc	0

15 Te ardhurat te tjera

Paraqiten te ardhura ne shumen 259,341 leke dhe perfaqeson te ardhurta e analizuar me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Te ardhura nga demshperblimet	0	8,557
2	Fitime nga kurset e kembimit	259,341	0
3	Te ardhura nga interesat (hua)	0	0
4	Te ardhura nga zbritja e furnitorit	0	204,349
	Shuma	<u>259,341</u>	<u>212,906</u>

16 Shpenzime financiare

Paraqitet ne shumën 63,419 lekë dhe përfaqëson shumën e shpenzimeve nga interesi për vitin 2020.

Nr	Emërtimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Humbje nga kursi i këmbimit	0	0
2	Shpenzime për interesa bankare	63,419	47,910
	Shuma	<u>63,419</u>	<u>47,910</u>

17 Llogaritja e rezultatit tatimor

Nr	EMERTIMI	VITI 2020	VITI 2019
1	Të ardhura	179,930,134	29,819,883
2	Shpenzime	-	-
		170,197,261	28,598,245
3	Rezultati	<u>9,732,873</u>	<u>1,221,638</u>
4	Shpenzime te pazbritshme	<u>4,231,187</u>	<u>24,350</u>
	a) Gjoha e penalitete	10,000	0
	b) Shpenzime pa fature tatimore	1,022,322	
	c) Provizione per zhvlersimin e inventareve	3,198,865	
5	d) Paga te likujduara me arke	0	24,350
6	Fitimi I tatueshem	<u>13,964,060</u>	<u>1,245,988</u>
7	Tatimi I fitimit	-2,094,609	-186,898
	Fitimi neto	<u>7,638,264</u>	<u>1,034,740</u>

Per vitin ushtrimor 2020 shoqeria paraqitet me nje fitim neto prej 7,638,264 leke.

18 Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2020 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

19 Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Hartuesi i Pasqyrave

Administratori